

VENDIM
Nr.803, datë 17.4.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT SATELITOR “TV ALSAT”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat satelitor “TV Alsat”, në fushën e transmetimeve televizive satelitore.
2. Pas heqjes së masës së sigurimit të padisë, subjekti “TV Alsat” të kryejë menjëherë rregullimet përkatëse në strukturën e aksionarëve, sipas përcaktimeve të nenit 20 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar.
3. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
4. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)